



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:142080

Datë: 14.10.2021

Numri i dokumentit: 02282022

C.nr.752/20

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, Gjyqtarja Afijete Sada - Gllogjani, me zyrtaren ligjore Albana Curri, duke vendosur në çështjen juridike të paditësve A. K., H. Ll. dhe M. J., që të gjithë nga Gjakova, të përfaqësuar nga Arbër Guta, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria për Punë Inspektuese në Gjakovë, e përfaqësuar nga e autorizuar Vjollca Shyti, kontest pune -për kompensimin në rast të pensionimit dhe shpërblimin jubilar, vlera kontestit 5,424.00€, pas përfundimit të shqyrtimit përgatitor të mbajtur me 07 tetor 2021, në prezencën e të autorizuarve të ndërgjyqëse, me datë 14 tetor 2021, murr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit A. K. nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që të “Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Punë Inspektuese në Gjakovë, që paditësit të ia kompensojë dy (2) paga në lartësi të pagës së fundit, në emër të pagave përcjellëse pas pensionimit, si dhe tri (3) paga, në emër të shpërblimit jubilar, e të gjitha këto së bashku shumën prej 2,370.45 euro, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në vit, e cila rrjedhë nga momenti i ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, e që këtë kompensim t’a realizojë në afatin prej 7 ditësh, prej marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ” **SI E PA BAZUAR.**

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses H. Ll. nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që të “Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Punë Inspektuese në Gjakovë, që paditëses të ia kompensojë dy (2) paga në lartësi të pagës së fundit, në emër të pagave përcjellëse pas pensionimit, si dhe një (1) pagë, në emër të shpërblimit jubilar, e të gjitha këto së bashku shumën prej 1,245.48 euro, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në vit, e cila rrjedhë nga momenti i ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, e që këtë kompensim t’a realizojë në afatin prej 7 ditësh, prej marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit ” **SI E PA BAZUAR.**

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses M. J. nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që të “Detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria për Punë Inspektuese në Gjakovë, që paditëses të ia kompensojë dy (2) paga në lartësi të pagës së fundit, në emër të pagave përcjellëse pas pensionimit, si dhe tri (3) paga, kjo në emër të shpërblimit jubilar, e të gjitha këto së bashku shumë prej 1,808.7 euro, duke e llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në vit, e cila rrjedhë nga momenti i ushtrimit të padisë, e deri në pagesën definitive, e që këtë kompensim t’a realizojë në afatin prej 7 ditësh, prej marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimi ” **SI E PA BAZUAR.**

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit me padi dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të tyre kanë parashtruar se kanë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. Paditësi i parë A. K., ka përvojë pune 33 vjet, shtatë muaj, e 23 ditë.

Paditësi A., në vitin 2003 është sistemuar në punët dhe detyrat e Inspektorit Sanitar në Drejtorinë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës nga data 01 qershor 2003 deri me datë 23 tetor 2019 deri në arritjen e moshës së pensionimit. Ka qenë anëtar i Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës, duke kontribuar me 0.5% nga paga e tij. Me vendimin e datës 04 nëntor 2018, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, paditësit i është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës në kategorizimin për Pension Kontribut pagues të moshës, e cila kërkesë i është aprovuar me 23 tetor 2019 dhe është kategorizuar në kategorinë e katërt me pagesë mujore prej 265.00 euro. Meqenëse e paditura, këtu paditësit i ka njohur vetëm një pagë përcjellëse pas pensionimit, i njëjti kërkon kompensimin edhe të dy pagave përcjellëse si dhe tre paga jubilarë për shpërblim jubilar, të parapara në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Paditësja e dytë H. Ll., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese, si Inspektore e Tregut nga data 15 maj 2003 e deri me datë 23 qershor 2019, deri në arritjen e moshës së pensionimit. Paditësja ka përvojë pune 16 vjet, një muaj dhe 8 ditë. Që nga viti 2012 e deri në pension, ka qenë anëtare e Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës duke kontribuar me 0.5% nga paga e saj. Me vendimin e datës 10 korrik 2019, të lëshuar nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale – Departamenti i Pensioneve, paditëses i është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës në kategorizimin për Pension Kontribut-pagues të moshës, e cila kërkesë i është aprovuar me 23 qershor 2019 dhe është kategorizuar në kategorinë e katërt me pagesë mujore prej 265.00 euro. E paditura, këtu paditëses i ka njohur vetëm një pagë përcjellëse pas pensionimit, ashtu që e njëjta kërkon që t'i kompensohen edhe dy paga të tjera përcjellëse si dhe një page jubilarë në emër të shpërblimit jubilar, të parapara në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Paditësja e tretë M. J., ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese e sistemuar në vendin e punës punëtore Administrative dhe punë kompjuterike. nga data 21 nëntor 1977 e deri me 10 gusht 2020, deri në arritjen e moshës së pensionimit. Paditësja ka përvojë pune 42 vjet, nëntë muaj, e 8 ditë. Që nga viti 2012 e deri në pension, ka qenë anëtare e Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës duke kontribuar me 0.5% nga paga e saj. E paditura, këtu paditëses i ka njohur vetëm një pagë përcjellëse pas pensionimit, ashtu që e njëjta kërkon që t'i kompensohen edhe dy paga të tjera përcjellëse si dhe tre paga jubilarë në emër të shpërblimit jubilar, të parapara në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Kërkesat e paditësve bazohen në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të datës 18 mars 2014, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01 janar 2015 dhe skadon me datë 31 dhjetor 2018, me mundësi vazhdimi edhe për 6 muaj, përkatësisht neni 53 dhe 53 të saj ka paraparë të drejtën për shpërblim jubilar dhe përcjellje në pension.

I autorizuari i paditësve në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat e administruara dhe thëniet e mëhershme është vërtetuar me pa mëdyshje baza juridike dhe lartësia e kërkesë padisë. Fillimisht bazuar nenin 81 paragrafi 2 të MPKK është përcaktuar se kjo marrëveshje e cila kishte vlefshmërinë 3 vjeçare mund të vazhdohet edhe për një vit për të gjithë anëtarët nënshkruese të kësaj marrëveshje e të cilat nënshkruajnë marrëveshje të reja kolektive. Neni 2 i kësaj Marrëveshje përcakton fushëveprimin e marrëveshjes e cila vlen për të gjithë sektorin privat, publik dhe shtetëror në Republikën e Kosovës. Duke qenë se pala e paditur e ka bërë pjesërisht pagesën e shpërblimit jubilar dhe pagave përcjellës në një farë mënyrë e ka pranuar legjitimitetin për të paguar këto kompensime duke qenë se kjo kontratë apo marrëveshje ka qenë e detyrueshme edhe për këtë rast të paditurën Komuna e Gjakovës konsiderojnë se e njëjta ka për obligim që të përmbush të gjitha detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje e kjo duke bazuar nenin 8 të LMD-së. Nga provat e administruara për paditësin A. K. u vërtetua se i njëjti ka qenë i punësuar tek e paditura deri në momentin e pensionimit, po ashtu u vërtetua se ka më shumë 33 vite përvojë punë dhe se i njëjti ka qenë anëtarë i sindikatës. Paditësi A. ka realizuar të ardhura mujore 474.09€, dhe duke qenë se është kompensuar me një pagë përcjellëse të njëjtit i takon e drejta edhe dy paga përcjellëse në shumë prej 948.18€, ndërsa shpërblimi jubilar në lartësi 3 pagave në shumën

prej 1,422.27€. Padiësja H. Ll. është vërtetuar se ka qenë e punësuar pranë të paditurës deri në momentin e pensionimit dhe e njëjta ka qenë anëtare e sindikatës, ka përvojë pune më shumë se 16 vite. Padiësja ka realizuar të ardhura mujore 415.40€, andaj e njëjta kërkon kompensim edhe për dy paga përcjellëse në lartësi prej 830.08€ dhe një shpërblim jubilar në shumë prej 415.40€. Padiësja tretë M. J. është vërtetuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në rastin e pensionimit dhe ka gjithsejtë 42 vite 9 muaj dhe 11 ditë përvojë pune. E njëjta ka qenë anëtarë e sindikatës dhe ka realizuar të ardhura mujore prej 361.74€. Andaj, padiësja kërkon kompensimin e dy pagave përcjellëse në shumë prej 723.48€ dhe shpërblimin jubilar në lartësi të tri pagave në shumën prej 1,085.22€. Të gjitha këto kërkesa janë të bazuara në nenin 52 të Marrëveshjes kolektive ku janë të përcaktuara specifikisht shpërblimet jubilarë bazuar në vitet e përvojës së punës ndërsa kompensimi me rastin e pensionimit është i përcaktuar në nenin 53 të kësaj Marrëveshje. Meqenëse është e ditur se padiësit janë shërbyes civil nëse gjykata eventualisht do të vendos lidhur me kompetencës atëherë i kërkojmë që konform nenin 392 të LPK-së lëndën ta bartë te gjykata kompetente. Gjykatës i propozojmë të aprovohet si e bazuar padia e padiësve A. K., H. Ll. dhe M. J. që të gjithë nga Gjakova dhe të detyroi të paditurën të bëjë kompensimin e kërkuar.

Shpenzimet procedurale i kërkojë për përpilimin e padisë për tre padiës shumën prej 208.00€, përfaqësimi në seancë për tre padiës shumën prej 270.40€, taksë gjyqësore në shumë prej 60.00€, gjithsejtë shumën prej 538.40€.

E autorizuar e të paditurës në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit dhe në fjalën përfundimtare ka kundërshtuar në tërësi bazën ligjore dhe lartësinë sipas pretendimit të padisë, për shkak se çështja e pensionimit tek shërbyesit civil të Republikës së Kosovës rregullohet me ligje të veçanta për rregullimin e marrëdhënies së punës dhe atë siç është Ligji për Shërbyesit Civil të Kosovës, nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr.33/2012 e dedikuar për shtesat në pagat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil. Bazuar në këto dispozita ligjore i propozoi gjykatës që të nxjerr aktvendim për refuzimin e kërkesëpadiësë së padiësve si të pathemeltë. Pas administrimit të provave si dhe rrethanave jo kontestuese me të cilat u vërtetua se tre padiësit kanë cilësinë e nëpunësit civil dhe në momentin e arritjes së moshës me rastin e daljes në pension ishin të punësuar pranë të paditurës, konsideroj se gjykata ka prova të mjaftueshme që padinë dhe kërkesë padinë e padiësve t'a refuzojë si të pabazuar për shkak se çështja e kompensimit të pagave përcjellëse pas pensionimit dhe shpërblimit jubilar, është e rregulluar me ligje të veçanta siç është cekur në përgjigje në padi. Ligji për pagat e nëpunësve civil dhe Rregullorja për shtesa në pagë është Ligj special. Vlen të theksohet se e paditura nuk është nënshkruese asnjë lloj të MPKK apo ndonjë Kontrate Sektoriale e cila do të kishte rrjedhur pas kësaj marrëveshje. Andaj, nën supozimin që e paditura edhe po të ishte nënshkruese e kësaj Marrëveshje të vitit 2014 e cila ishte në fuqi nga data 01 janar 2015 deri në janar të vitit 2018, duke u bazuar në provat e padiësve kuptohet që të njëjtit në vitin 2019 kanë arritur moshën e pensionimit, gjë që kuptohet se kjo marrëveshje dhe fuqia e saj janë pa efekt juridik. Gjykatës i propozojë që padinë dhe kërkesëpadinë e padiësve të e refuzoi në tërësi si të pabazuar.

Shpenzime procedurale nuk kërkojë.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata ka bërë nxjerrjen e provave si: Vërtetimin 06-313-5474, datë 6 shtator 2011, certifikatën nr. 06/293 datë 6 shtator 2011, librezën e punës në fotokopje nr. regjistrin 32344, vërtetimin për përvojën e punës datë 29 shtator 2020, ekstraktin për stazhin e punës dhe të ardhurat, datë 04 nëntor 2019, vërtetimin 070-2020, datë 29 shtator 2020, vërtetimin e datës 29 shtator 2020, vendimin e MPMS - Departamenti i Pensioneve, datë 04 nëntor 2019, akt emërimit 01 nr.2012-143/2012, datë 01 mars 2012, vendimi 01-nr.118/02-38414, datë 10 shtator 2019, monitorimin e transaksionit të llogarisë, datë 29 shtator 2020 të lëshuar TEB Bank, për padiësin A. K.. Vërtetimi 068/2020, datë 29 shtator 2020, vërtetimin e lëshuar me 28 shtator 2020, vendimin e MPMS - Departamenti i Pensioneve, datë 10 korrik 2019, vendimi 01 nr. 01-400-01-17638, datë 07 maj 2019, përshkrimi i transaksionit Raiffaisen Bank, datë 28 shtator 2020, akt emërimi 01 nr. 112-143/5, datë 01 mars 2012 për padiësen H. Ll.. Vendimi 01 nr.118-01-11147, datë 01 qershor 2020, vërtetimi i marrëdhënies së punës 112-045-2020, datë 05 qershor 2020, vërtetimi i datës 01 tetor 2020, akt emërimit

01 nr.112-143-18, datë 01 mars 2012, historiatin e llogarisë Banka Ekonomike, datë 01 tetor 2020, lista e pagave për muajin korrik 2020 për paditësen M. J. dhe lista e pagave për muajit tetor 2019 dhe lista e pagave për muajin dhjetor 2015, për të gjithë paditësit, ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe lidhshmërinë e tyre reciproke, e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësve, është e pa bazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga provat e zbatuara në këtë çështje kontestimore, rezultojë gjendja faktike si në vijim:

Nga Vërtetimi 06-313-5474, datë 06 shtator 2011 provohet se paditësi A. K., ka ushtruar veprimtarinë Mishshitës dhe këtë me Vendimin e ish Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa pranë K.K-ës – Gjakovë, me nr. të vendimit 03-313-443, datë 01 nëntor 1995 dhe të njëjtën veprimtari nuk e ka mbyllur gjer me fillimin e luftës së bërë në Kosovë. Nga certifikata nr. 06/293 datë 06 shtator 2011, e lëshuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, provohet se paditësi e ka ushtruar veprimtarinë mishshitës, të cilën veprimtari e ka ushtruar sipas Aktvendimit të lëshuar nga Drejtoria për Ekonomi e Financa – K. Gjakovë, me nr. 03-313-443, nga data 01 nëntor 1995, këtë veprimtari e ka ushtruar gjer në fillimin e luftës. Sipas Librezës së Punës në fotokopje nr. regjistrin 32344, vërtetohet faktet e lartë shënuar për periudhën 01 korrik 1980 deri me 08 prill 1981 ka përvojë pune 9 muaj e shtatë ditë, nga data 25 mars 1982 deri me 31 dhjetor 1989, ka përvojë pune 7 vite , 9 muaj 6 ditë nga data 01 janar 1990 deri me 31 tetor 1995, ka përvojë 5 vite, 10 muaj, nga data 01 nëntor 1995 deri me 31 dhjetor 1998, ka përvojë pune 3 vite, 2 muaj së fundi Ndërmarrjen e pavarur “. . .” Gjakovë. Nga vërtetimi i të paditurës për përvojën e punës, datë 29 shtator 2020 provohet fakti se paditësi ka qenë i sistemuar në punët dhe detyrat e punës Inspektor Sanitar në Drejtorinë për punë inspektuese, në kuadër të Kuvendit Komunale në Gjakovë nga data 01 qershor 2003 deri me 23 tetor 2019. Nga vërtetimi i datës 29 shtator 2020, provohet fakti se paditësi ka qenë anëtar i Shoqatës Sindikale të Administratës së Kosovës prej vitit 2012 deri në pensionim 23 tetor 2019. Nga vendimi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i pensioneve, datë 04 nëntor 2019 provohet rrethana se paditësit i është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës në Kategorizim për Pension Kontribut pagues të Moshës, e cila kërkesë është aprovuar me datë 23 tetor 2019 dhe i njëjti është kategorizuar në kategorinë e katër. Nga akt emërimi 01 nr.2012-143/2012 datë 01 mars 2012, është provuar fakti se Komuna e Gjakovës në pajtim me nenet 96 dhe 97 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kontratën e punës me 01 nr. 112-143-106, datë 25 shkurt 2011 e shndërron në akt emërim për paditësin. Nga vendimi 01-nr.118/02-38414, datë 10 shtator 2019, vërtetohet se paditësi A. K., i sistemuar në vendin e punës Inspektor Sanitar në Drejtorinë për Punë Inspektuese, përfundimisht i përfundon marrëdhënia e punës me datë 23 tetor 2019 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Nëpunësit t'i llogaritet dhe paguhet kompensimi për shkak të pensionimit në lartësinë e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit. Vendimi hyn në fuqi me 23 tetor 2019. Nga monitorimi i transaksionit të llogarisë datë 29 shtator 2020, të lëshuar nga TEB Bank, provohet fakti se paditësi me 31 tetor 2019 ka realizuar pagë mujore në lartësi 413.82 euro.

Nga vërtetimi 068/2020, datë 29 shtator 2020, provohet se paditësja H. Ll., ka qenë e sistemuar në vendin e punës Inspektore e Tregut në Drejtorinë për Punë Inspektuese, tek e paditura nga data 15 maj 2003, e deri me datë 23 qershor 2019. Nga vërtetimi datë 28 shtator 2020, provohet fakti se paditësja ka qenë anëtare e Shoqatës Sindikale të Administratës së Kosovës prej vitit 2012, deri në pensionim 23 qershor 2019. Nga vendimi i Ministrisë Punë dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Pensioneve, datë 10 korrik 2019, provohet rrethana se paditëses i është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës në Kategorizim për Pension Kontribut pagues të Moshës, e cila kërkesë është aprovuar me datë 23 qershor 2019 dhe i njëjta është kategorizuar në kategorinë e katër. Nga Vendimi 01 nr.01-400-01-17638, datë 07 maj 2019, provohet fakti se paditësja e sistemuar në vendin e punë Inspektore e Tregut në Drejtorinë për Punë Inspektuese, përfundimisht i përfundon marrëdhënia e punës me 23 qershor 2019, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Nëpunëses t'i llogaritet dhe paguhet kompensimi për shkak të pensionimit në lartësinë e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit. Vendimi hyn në fuqi me 23 qershor 2019. Nga akt emërimi 01 nr.112-143/5, datë 01 mars 2012 vërtetohet fakti se e paditura Komuna e Gjakovës në pajtim me nenet 96 dhe 97 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së

Kosovës, kontratën e punës 01 nr. 112-143-105, datë 25 shkurt 2011 e shndërron në akt emërim për paditësen. Nga përshkrimi i transaksionit të lëshuar nga Raiffaisen Bank, datë 28 shtator 2020, vërtetohet se paditësja me 28 qershor 2019 ka realizuar pagë mujore në lartësi 415.40 euro.

Nga vendimi 01 nr.118-01-11147 datë 01 qershor 2020 provohet fakti se paditësja M. J., e sistemuar në vendin e punës Punëtor Administrative dhe Punë Kompjuterike, në Drejtorinë për Punë Inspektuese pran të paditurës, i ndërpritet marrëdhënia e punës me 10 gusht 2020, për shkak të moshës së pensionimit. Nëpunëses t'i llogaritet dhe paguhet kompensimi për shkak të pensionimit në lartësinë e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit. Vendimi hyn në fuqi me 10 gusht 2020. Nga vërtetimi marrëdhënies së punës 112-045-2020 datë 05 qershor 2020, provohet fakti se paditësja ka filluar punën në Komunën e Gjakovës me 21 nëntor 1977 deri me 10 gusht 2020. Nga vërtetimi i datës 01 tetor 2020, vërtetohet se paditësja ka qenë anëtare e Shoqatës Sindikale të Administratës së Kosovës prej vitit 2012 deri në pensionim 10 gusht 2020. Nga akt emërimi 01 nr.112-143-18, datë 01 mars 2012, vërtetohet fakti se e paditura Komuna e Gjakovës në pajtim me nenet 96 dhe 97 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kontratën e punës me 01 nr. 112-143-112, datë 25 shkurt 2011 e shndërron në akt emërim për paditësen. Nga historiat i llogarisë i lëshuar nga Banka Ekonomike, datë 01 tetor 2020, vërtetohet se paditësja gjatë muajit korrik 2020 ka realizuar pagë mujore në lartësi 361.40 euro ndërsa në muajin shtator 2020 ka realizuar shumën 381.20 euro.

Nga provat e administruar rezulton se paditësi A. K. ka qenë punëtor i të paditurës deri në rastin e pensionimit me datë 23 tetor 2019, ka punuar tek e paditura në punë dhe detyrat e punës Inspektor Sanitar në Drejtorinë për Punë Inspektuese dhe ka pas cilësinë e shërbyesit civil. Gjatë muajit dhjetor 2015 ka realizuar shpërblimin jubilar në shumë prej 93.50€. Paditësi ka mbi 30 vite përvojë pune. Tek e paditura ka qenë në marrëdhënie pune nga data 01 qershor 2003 deri me datë 23 tetor 2019.

Paditësja e dytë H. Ll. ka qenë e sistemuar në punë dhe detyrat e punës në Drejtoratin e Inspektoratit të tregut si Inspektore Tregu deri në pensioni 23 tetor 2019 dhe ka realizuar shpërblimin jubilar në shumë 93.50€ me pagën e muajit dhjetor 2015. Paditësja ka përvojë pune nga data 15 maj 2003 deri me 23 qershor 2019 dhe ka 16 vite përvojë pune.

Paditësja M. J. ka qenë e sistemuar në të njëjtën Drejtori si Punëtor Administrative dhe punë kompjuterike me pagën e muajit dhjetor 2015 ka realizuar shpërblimin jubilar në shumë 93.50€. Ka punuar tek e paditura pa ndërprerje nga data 21 nëntor 1977 deri me datë 10 gusht 2020 kur është pensionuar dhe ka mbi 40 vite përvojë pune. Të gjithë paditësit kanë pranuar edhe një pagë të menjëhershme me rastin e pensionimit rrethana të vërtetuara nga transaksionet e llogarive bankare, ku kanë realizuar të ardhurat.

Sipas nenit 22 të Ligjit nr.03/L-147 për pagat e nëpunësve civil, nëpunësit kanë të drejtë për kompensim për rastet në vijim; paragrafi.2.2 pagesë për shkak të pensionimit dhe 2.3 shpërblimi i përvjetorit (jubile).

Me Rregulloren numër 33/12 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, neni 19 përcakton pagesat për pension. Paragrafi 1, sipas nenit 22 të Ligjit për pagat e nëpunësve civil, nëpunësit që arrijnë moshën e pensionimit në shërbimin civil, gëzojnë të drejtën e kompensimit. Paragrafi 2 i nenit 19 të kësaj Rregullore parasheh se "nëpunësi civil, që arrijnë moshën e pensionimit gëzojnë të drejtën e marrjes së një pagese në shumë prej një page mujore të menjëhershme në vlerën e pagës së fundit". Neni 21 parasheh shpërblimin e përvjetorit (jubile) sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e nëpunësve civil, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në shërbimin civil ju takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në shërbimin civil pas çdo 10 vjetësh pune. Nuk është paraparë që të paguhet shpërblim jubilar pas pensionimit, por kur nëpunësit civil janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune iu takon një shpërblim pas çdo 10 vjetësh pune ashtu siç paditësit e kanë realizuar me

pagën e muajit dhjetor 2015 nga 93.50€, po ashtu kanë realizuar edhe një pagë të menjëhershme pas pensionimit (pagë e cila nuk është objekt).

Tek nëpunësit civil çështja e kompensimit të pagave përcjellëse pas pensionimit dhe shpërblimi jubilar janë rregulluar me ligje të veçanta, Ligjin për pagat e nëpunësve civil dhe Rregulloren numër 33/12 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera është Ligj special që detyron të paditurën në kompensime.

Pretendimet e të autorizuarit të paditësve se baza juridike për kompensimin e kërkuar të pagave përcjellëse dhe shpërblim jubilar ka mbështetje në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive është i pa qëndrueshëm, sepse MPKK e datës 18 mars 2014 ishte në fuqi nga data 01 janar 2015 deri me datë 01 janar 2017. Neni 81 paragrafi 2 dhe 3 i asaj Marrëveshje përcakton se nëse MPKK, pasi që i ka skaduar afati i përcaktuar tre vjeçar nuk tërhiqet asnjë nga palët nënshkruese, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit. Pas skadimit të afatit të MPKK, lidhet marrëveshje e re. Fillimi i punës së Marrëveshjes së re, në fillim të afatit gjashtë mujor përdoren rregullat dhe dispozitat e MPKK – së vjetër e që në këtë çështje lëndore nuk ka efekt juridik, sepse Ligji Special derogon Ligjin e përgjithshëm.

Sipas nenit 90 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit të Punës, Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri vjet dhe vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshje Kolektive.

Bazuar në mos kërkesën e shpenzimeve procedurale nga pala e paditur dhe mos suksesin e paditësive në këtë proces gjyqësor sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së kërkesa e palës paditëse për kompensim të shpenzimeve gjyqësore u refuzua si e pa bazuar.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.752/2020, me 14 tetor 2021

G j y q t a r j a,
Afijete Sada - Glllogjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.